



Zbatimi i METD – Informatë e përgjithshme

Nëse Personi jo rezident ka aktivitete në Kosovë dhe ekziston një METD atëherë duke u bazuar në Nenet përkatëse të ardhurat mund t'i nënshtrohen tatimit në Kosovë.

Bazuar në METD do të merren parasysh vetëm tatimet mbi të ardhurat që mbuloohen nga METD:

1. Të ardhurat nga investimet pasive ose të portfolios që rrjedhin nga mbajtja e pasurisë që sjell interes, dividendë ose honorarë të paguara nga një person ose njësi në Kosovë.
2. Të ardhurat nga një biznes i ofrimit të shërbimeve, nëse i atribuohen apo jo një bazë fikse ose një njësi të përhershme të jo-rezidentit në Kosovë.
3. Të ardhurat nga zhvillimi i biznesit nëse i atribuohen apo jo një njësi të përhershme të jo-rezidentit në Kosovë.
4. Të ardhurat nga punësimi që ushtrohen në Kosovë.
5. Të ardhurat nga fitimet e realizuara nga jo-rezidenti në Kosovë.

Lidhur me tatimin e jo-rezidentëve për të ardhurat që krijohen në Kosovë fillimisht do të bëhet identifikimi i jo-rezidentëve. Për ata persona që fitojnë të ardhura nga aktivitetet e biznesit në Kosovë, informacioni do të merret nga paguesi rezident.

Paguesi rezident do e zbatojë METD dhe pastaj brenda vitit fiskal nga data e pagesës së faturës, është i obliguar të dorëzojë në ATK formularët si në vijim si dhe dokumentacionin përkatës:

1. Formular aplikimi për Interesin;
2. Formular aplikimi për Dividentë;
3. Formular aplikimi për të Drejtat Pronësore;
4. Formular aplikimi për Fitimet Kapitale;
5. Formular aplikimi për të Ardhurat Tjera;
6. Formular aplikimi për të ardhurat nga shërbimet e pavarura;
7. Formular aplikimi për të ardhurat nga shërbimet e varura;
8. Formular aplikimi për të ardhurat biznesore.

Paguesi rezident para dorëzimit të formularit mund t'i drejtohet ATK për përgjigje lidhur me zbatimin e METD përkatëse. ATK pasi të verifikojë se formulari dhe dokumentacioni përkatës janë të kompletuara, i përgjigjet paguesit rezident për pranimin e kërkesës së paraqitur. Paguesi rezident gjatë dorëzimit të formularit do të pajiset me numër protokolli të ATK.